

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Qytetet që rrezikojnë të zhduken deri në vitin 2050! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/qytetet-qe-rrezikojne-te-zhduken-deri-ne-vitin-2050/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA

KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 08:10:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 08:10:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	12d47fd20bfffedcfc5595b11b56df726cbcdc0dd01b7b9fe92423da022f7c24
TEKSTI	0d841fd33a102bdd7b63f529527bb434ecb183b169f5c4bd73f2f6ea00ee9bd5
PAMJA	8129ca6e089337418561ab436405c314f6bbf40679bac309f6831fe9ba49fed7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9f9157102e83ac14c418437445866337afb0aaafc283241d0d987f176d8db9d8f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9a66b9440a0861df2d438551387cc4c0076e19988df5fe9b1c9268bd2c93d904
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9f9157102e83ac14c418437445866337afb0aaafc283241d0d987f176d8db9d8f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bota

Qytetet që rrezikojnë të zhduken deri në vitin 2050!



Marisa Karabeci

16 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Mbi 570 qytete bregdetare dhe 800 milionë banorë janë në rrezik për shkak të rritjes së nivelit të detit dhe fundosjes së tokës. Në këtë përfundim ka arritur një raport me titullin “E ardhmja që nuk e duam” nga rrjeti ndërkombëtar i qyteteve C40, sipas të cilit këto qytete do të jenë të ekspozuara ndaj rritjes së nivelit të detit dhe përmbytjeve gjithnjë e më të shpeshta. Situata do të përkeqësohet nëse nuk merren masa urgjente në nivel global, jo vetëm në lidhje me ngrohjen, por edhe me situata si fundosja e tokës, erozioni ose humbja e sedimenteve.

Ja 10 qytetet që rrezikohen deri në vitin 2050:

Nju Orleans (SHBA)

Pjesa më e madhe e qytetit, vendlindja e xhazit, është tashmë nën nivelin e detit dhe e mbrojtur nga një sistem kompleks digash dhe pompash hidraulike. Pas uraganit Katrina në vitin 2005, u investuan miliarda në përmirësimin e mbrojtjes, por toka vazhdon të ulet dhe ligatinat që shërbenin si barrierë natyrore po pakësohen. Ekspertët besojnë se shpëtimi i saj do të kërkojë shpenzime gjithnjë e më të mëdha.

Miami (SHBA)

As delta lumenjsh dhe as pellgje liqenesh, por shkëmbinjtë gëlqerorë shumë porozë. Qyteti më i famshëm i Floridës ndodhet në këtë terren, duke lejuar që uji i detit të depërtojë nën tokë, duke anashkaluar digat dhe barrierat. Kësaj i shtohet edhe rritja e nivelit të detit, i cili shkakton përmbytje gjatë baticave të larta. Për shkak të këtyre veçorive, ekspertët e konsiderojnë Miamin një nga skenarët më sfidues të përshtatjes ndaj klimës.

Qyteti i Meksikos

I ndërtuar në pellgun e liqenit të lashtë Texcoco, kryeqyteti meksikan nuk i frikësohet detit, por tokës mbi të cilën ndodhet. Nxjerrja masive e ujërave nëntokësore shkakton një nga shkallët më të

shpejta te fundosjes ne planet, me token qe fundoset me rreth 20-30 cm ne vit . Kjo shkakton deme te vazhdueshme ne rrugë dhe infrastrukturë, duke e bërë jetën të vështirë për një megalopol me 21 milionë banorë.

Aleksandria (Egipt)

E themeluar nga Aleksandri i Madh në vitin 331 para Krishtit, Aleksandria është një nga qytetet më të vjetra në Mesdhe. Sot, ajo kërcënohet nga erozioni bregdetar dhe ngrohja globale, të cilat po shkaktojnë depërtimin e ujit të kripur në deltën e Nilit. Sipas disa studimeve, ajo do të duhet të përshtatet me përmbytjet e përsëritura, të cilat do të shkaktojnë dëme të konsiderueshme jo vetëm në bujqësi, por edhe në trashëgiminë e saj të çmuar arkeologjike.

Bangkok (Tajlandë)

I vendosur në deltën e lumit Chao Phraya, është ndërtuar në tokë të butë dhe të paqëndrueshme. Shumë zona të qytetit janë afërsisht dy metra nën nivelin e detit dhe studimet parashikojnë përmbytje në rritje bregdetare gjatë dekadave të ardhshme. Shirat më intensivë të musoneve dhe ndryshimet klimatike kërcënojnë të shkatërrojnë një metropol me mbi 10 milionë banorë.

Xhakarta (Indonezi)

I themeluar në shekullin e 5-të në deltën e 13 lumenjve, ai është fundosur më shumë se katër metra vitet e fundit dhe sot afërsisht 40% e zonës urbane është tashmë nën nivelin e detit. Ky kombinim i fundosjes dhe rritjes së nivelit të detit ka nxitur qeverinë lokale të investojë 32 miliardë dollarë për të ndërtuar një kryeqytet të ri, Nusantara, nga e para në xhunglën e Borneos, ku të gjitha aktivitetet do të zhvendosen gradualisht.

Manila (Filipine)

Kryeqyteti i njërit prej shteteve më të prekshme në botë ndaj tajfunëve dhe përmbytjeve, Manila po përballlet gjithashtu me problemin e dyfishit të fundosjes së tokës, të shkakuar nga mbishfrytëzimi i ujërave nëntokësore dhe rritja e nivelit të detit. Disa zona të metropolit po fundosen me rreth dy centimetra në vit dhe, pa ndërhyrje radikale, mund të jenë nën ujë deri në fund të shekullit.

Qyteti Ho Çi Min (Vietnam)

Zemra ekonomike e Vietnamit, ai shtrihet në një rajon jashtëzakonisht të prirur ndaj përmbytjeve, me afërsisht 40-45% të zonës urbane që shtrihet më pak se një metër mbi nivelin e detit. Përveç rritjes së nivelit të detit, qyteti përballlet me fundosje të shkakuar nga nxjerrja e ujërave nëntokësore, një efekt i kombinuar që rrit rrezikun e përmbytjeve kronike në shumë lagje.

Venecia (Itali)

Është ndoshta qyteti më i famshëm në botë kur bëhet fjalë për rrezikun klimatik. Laguna Serenissima ndodhet pak mbi nivelin e detit dhe qyteti vazhdon të fundoset ngadalë ndërsa nivelet e detit rriten. Sistemi i digave mobile MOSE ka ulur rrezikun e përmbytjeve ekstreme, por shkencëtarët besojnë se masa të mëtejshme përshtatjeje do të jenë të nevojshme në planin afatgjatë.

Amsterdam (Holandë)

I ndërtuar midis kanaleve, polderëve dhe tokave të ulëta, Amsterdami mbrohet nga diga, pompa dhe barriera që e bëjnë Holandën një model global për mbrojtjen e ujit. Megjithatë, rreziku mbetet real: sipas Programit Holandez të Deltës, nivelet e detit përgjatë vijës bregdetare të vendit mund të rriten me më shumë se një metër deri në vitin 2100, duke i detyruar holandezët të rimendojnë mbrojtjen e tyre për të mbijetuar.

LAJME TË NGJASHME



Aksidenti tragjik zbuloi tradhtinë/Influenceri i makinave vdes bashkë me 22-vjeçaren që kishte udhëtuar për ta takuar!

2 MIN



VIDEO/Makina ndjek dhe përplas motoçikletën, momenti i frikshëm bëhet viral!

1.5 MIN



Filmohet momenti tragjik/U shtyp nga ballkoni i ndërtesës, humb jetën 74-vjeçari në Brazil...VIDEO!
1.5 MIN



E rëndë/Arena kthehet në "luftë", toreadori bllokohet mes brirëve të demit...VIDEO!
1 MIN



Dëshmia që po trondit rrjetin/51-vjeçari abuzoi seksualisht me mbesën e mitur, "viktimë" dhe e bija!
1 MIN

MË TË LEXUARAT



Reshje shiu në zonat malore dhe temperatura deri në 32°C, parashikimi i motit për sot



Gjykata speciale në Hagë jep sot vendimin për Thaçin dhe ish-krerët e tjerë të UÇK-së



Kush janë gjyqtarët që do të shpallin sot vendimin për ish-krerët e UÇK-së në Hagë?



Tension para Speciales në Hagë/ Policia holandeze përplasat me mbështetësit e ish-krerëve të UÇK-së!



FOTOT bëhen virale në rrjet/Pëson diarre gjatë garës, atletja nuk NDALET!



Rrëzohet kërkesa e Ilir Metës për lirim nga burgu!



Biletat për ndeshjet e Shqipërisë, edhe fizikisht pranë "Air Albania"-s!



"Burri e tradhtonte me shokun e ngushtë..."/ Shkënda Lili habit me rastin: Kishte kapur disa foto intime në...



Arrest i Erion Veliajt, sot çështja në Gjykatën e Lartë!



Oasis nuk ndalen! Liam dhe Noel Gallagher rikthehen sërish në skenë me 38 koncerte?


EDITORI SUGJERON



Një natë, shumë ritme dhe një ndalesë që nuk e kishim planifikuar!



Nga dëshira për të prekur "Eurovisionin" deri tek situata më e sikletshme në koncert, flet Lorenc Hasrama!



"Po sikur...?" Ja si mendimet më të zakonshme na fusin në alarm...



"Po du", Rilind Alimani tregon si arriti të realizojë bashkëpunimin me Elvana Gjatën: I kam shkruar që...



Truku i thjeshtë që ua heq lëkurën specave pa mundim, mjafton një hap pas pjekjes!





“Eksperimentova, shkoi shumë mirë”/Egji Tako flet për projektet e saj muzikore: Do kthehem tek baladat...



Të dobët dhe e keni të vështirë të shtoni peshë?! Proveni këto ushqime...



Të gjithë po shtojnë ekrane, Range Rover po bën të kundërtën!



Jeni të mërzhitur?! Bëni mirë të hani këto ushqime...



Mendoni se partneri juaj po ju tradhton?! Ja se si duhet të flisni me atë...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontaktimi
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.